

DEKRET
Nr. 13438, datë 20.1.2022

**PËR CAKTIMIN E DATËS SË ZGJEDHJEVE TË PJESSHME VENDORE PËR
KRYETAR BASHKIE, PËR DISA NJËSI TË QEVERISJES VENDORE**

Në mbështetje të nenit 92 shkronja “gj”, 93, 115, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të nenit 10, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të nenit 61, pika 4, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, pasi u njoha zyrtarisht me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 36, datë 4.11.2021, si dhe pasi kërkova dhe administrova informacionin dhe njoftimet sipas procedurës së kërkuar nga ligji nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve¹, Këshilli i Ministrave² dhe Gjykata Kushtetuese³, mbi të dhënat e plota për ato bashki, kryetarëve të të cilave u ka përfunduar mandati në mënyrë të parakohshme dhe për të cilat është i nevojshëm organizimi i zgjedhjeve të pjesshme për kryetarë bashkie,

DEKRETOJ:

Neni 1

Caktimin e datës 6 mars 2022 për zhvillimin e zgjedhjeve të pjesshme vendore, për kryetar bashkie, për këto njësi të qeverisjes vendore:

1. Bashkia Shkodër, qarku Shkodër;
2. Bashkia Dibër, qarku Dibër;
3. Bashkia Durrës, qarku Durrës;
4. Bashkia Vorë, qarku Tiranë;
5. Bashkia Rrogozhinë, qarku Tiranë;
6. Bashkia Lushnjë, qarku Fier.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

¹ Shkresë nr. 56/1 prot., datë 17.1.2022, e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve administruar me nr. 210 prot., datë 17.1.2022.

² Shkresë nr. 273/1 prot., datë 18.1.2022, e Këshillit të Ministrave, administruar me nr. 224 prot., datë 18.1.2022.

³ Shkresë nr. 41/1 prot., datë 19.1.2022, e Gjykatës Kushtetuese, administruar me nr. 248 prot., datë 20.1.2022.